



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Në mbështetje të nenit 15.2 të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 5, 6 dhe 7 të Rregullores (ZKA) 01/2024 për Pranimin dhe Karrierën në Zyrën Kombëtare të Auditimit, lidhur me nenin 47 të Rregullores (ZKA) 03/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës; Planit Vjetor të Rekrutimit për vitin 2025 si dhe Vendimit të Auditorës së Përgjithshme me Nr.275 dhe nr. 313 për plotësimin e vendit të lirë të punës, Zyra Kombëtare e Auditimit shpall:

KONKURS

për plotësimin e vendit të lirë të punës

Pozita:	Lektor
Numri i referencës:	LZKA/ZKA/07-03/25
Grada:	ZKA-E9
Numri i pozitave:	Një (1)
Kohëzgjatja e emërimit:	Me kohë të pacaktuar

Detyrat Kryesore:

1. Përgjegjës për sigurimin e cilësisë së lartë gjuhësore në të gjitha dokumentet që prodhon Zyra Kombëtare e Auditimit, duke përfshirë por jo kufizuar me raporte, shkresa zyrtare, vendime, udhëzime, komunikata dhe deklarata publike në gjuhën shqipe. Procesi përfshin rishikimin dhe redaktimin e teksteve për pasaktësi gramatikore, sintaksore dhe stilistike, duke siguruar që dokumentet rrjedhin në gjuhë të qartë, të thjeshtë dhe koncize, si dhe evituar mundësinë për keqinterpretime dhe dy kuptimësi.
2. Përgjegjës për sigurimin e saktësisë, kohezionit dhe njëtrajtshmërisë në përdorimin e frazeologjisë dhe terminologjisë, në përputhje me standardet profesionale dhe kërkesat e legjislacionit. Procesi mbetet thelbësor për të siguruar që gjuha e përmbajtjes së dokumentit mbetet koherente dhe komunikohet në mënyrën e duhur.
3. Përgjegjës për menaxhimin efikas të kohës, frymën e bashkëpunimit dhe ruajtjen e fokusit edhe nën presionin e afateve të ngushta. Procesi siguron përmbushjen e standardeve më të larta gjuhësore për nga cilësia dhe saktësia, pa komprometuar asnjërin aspekt.
4. Përgjegjës për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e sistemit të arkivimit të materialeve të lekturuara në përputhje me politikat e arkivimit.
5. Angazhimi në zhvillimin dhe mirëmbajtjen e bibliotekës së materialeve referuese, përfshirë fjalorët, udhëzuesit për shkrim dhe burimet gramatikore, në bashkëpunim të ngushtë me përkthyesit.
6. Përmbushja e detyrave të tjera sipas kërkesës dhe në përputhje me legjislacionin si dhe aktet normative në fuqi.

Kërkesat e përgjithshme formale, janë:

- Arsimimi: Diplomë fakulteti në gjuhë dhe letërsi;
- Përvoja profesionale: Tre (3) vite përvojë pune profesionale.

Shkathtësitë e kërkuara:

- Shkathtësi në komunikim dhe planifikim të punës.
- Shkathtësi në organizim të punës dhe përmbushje të objektivave;
- Njohuri të Akteve Juridike të aplikueshme në Zyrën Kombëtare të Auditimit;
- Aftësi motivuese dhe komunikuese në ekip;
- Të posedoj aftësi të mira ndër-personale.

Informata të përgjithshme për kandidatë:

Përcaktimi i pagës bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Procedura e Aplikimit:

Procedura e aplikimit është e hapur për të gjithë kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit. Zyra Kombëtare e Auditimit ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret kandidatët nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Kandidatët duhet t'i dorëzojnë dokumentet e nevojshme, si më poshtë:

- formularin zyrtar të ZKA-së për aplikim;
- kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- dëshmitë për përgatitjen arsimore (Diplomë fakulteti). Diplomat e fituara jashtë Kosovës duhet të jenë të nostrifikuara;
- dëshmitë për përvojën e punës (Kontratë Pune ose Vërtetim i Marrëdhënies së punës, të shoqëruara me dëshmi nga Trusti);
- dëshmia nga gjykata që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë (jo më e vjetër se gjashtë muaj);
- dëshmia që nuk ka në fuqi masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik (*nëse aplikohet*);

Vetëm formulari zyrtar për konkurrin do të merret parasysht. Dokumentet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk shqyrtohen kurse ato të pakompletuara do të refuzohen. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret do të kontaktohen. Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në mediat elektronike (*online*) dhe në faqen e internetit të Zyrës Kombëtare të Auditimit. Afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit është data **11.04.2025 ora 16.00**.

Formularët për aplikim mund të merren në recepcionin e ZKA-së, ose mund të tërhiqen nga faqja e internetit e ZKA-së në adresën www.zka-rks.org dhe dorëzohen në Divizionin për administrimin e dokumenteve në adresën: Lagja: Arbëria, rr. "Ahmet Krasniqi" nr. 210 – Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 08:00 – 16:00, formulari dhe dokumentet mbështetëse mund të dorëzohen edhe përmes adresës elektronike në adresën rekrutimi@oagks.org ose përmes postës. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr.tel. 038/606-004, ext:1025.

Shënim:

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim.